



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:078602

Datë: 28.05.2021

Numri i dokumentit: 01827774

P.nr.100/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale kundër të akuzuarës A.M. B., për shkak veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.3 lidhur me parag.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë PP. Nr.498/20 të datës 24.06.2020, përkatësisht të dt. 26.05.2021, me propozimin për dhënien e urdhrit ndëshkimor , jashtë seancës për shqyrtimin kryesor me dt.28.05.2021, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-Gjakovë Gjakovë PP. nr.498/20 të datës 24.06.2020, përkatësisht e dt. 26.05.2021, ndërsa Gjykata, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: A. M. B., e lindur me dt.... nga fshati A. Komuna e D. me nr. personal ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Për shkak se me datën 16.02.2020, në pompën e derivateve „V.P.” në fsh. S. komuna Malishevë, me anë të lajthimit dhe largimit, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit, në atë mënyrë që natën kritike e pandehura shmang pagesën për shërbime te derivateve duke u furnizuar me derivate në vlerë prej ... euro, dhe dukë mbajtur në dorë kartëmonedhën ... euro, dhe gjer sa punëtori i pompës së derivateve L. M., kishte dashur që t'ia kthej 10 euro, pasi që e dëmtuara kishte në dorë kartëmonedhën prej ... euro, e njëjta largohet nga aty pa bërë pagesën e furnizimit me derivate, me ç'rast ë dëmtuarës „V. P.” i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 40 euro.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 parg.3 lidhur me parg.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodit nr.06/L-074).

Andaj Gjykata konform nenit 38, 40, 43, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.06/L-074), si dhe nenit 365 e 495, të Kodit të Procedurë penale të njëjtin e gjykon me:

DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që e gjykon me dënimin me gjobë në shumën pre **200 €** (dyqind euro), të cilën shumë është e obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e gjykatës pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet e dënuara që në emër të paushallit gjyqësor, Gjykatës t'ia kompenzon shumën prej 20 €, ndërsa për programin për kompenzimin e viktimave të krimit shumën prej 30 euro,

E dëmtuara „V. P.“, nëç fsh. S. komuna e M., udhëzohet që kërkesën pasurore juridike, ta realizojë në kontestin rregullt civil.

Të tëra këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar në të holla nuk e paguan në afatin e cekur i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatjen prej 10 ditësh, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi nga 20 €.

A r s y e t i m

PTH-Gjakovë me aktakuzën PP.nr.498/20 të dt. 24.06.2020, përkatësisht datës 26.05.2021, me propozim për dhënien e urdhrin ndëshkimor, e ka akuzuar A.B., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që ta pranon kërkesën për urdhër ndëshkimor, më të cilin ta akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënon me dënimin me gjobë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes penale, vërtetoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 476 të KPPK-së dhe konform nenit 478 par.1 të KPPK së ,e aprovoi propozimin e PPK-së për dhënien e urdhrin ndëshkimor, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është vlerësim i gjykatës se provat që i janë të bashkangjitura propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor, e të cilat gjinden në shkresat lëndës janë: raporti i oficerit Sh. M. nr. ... i dt. 17.02.2021, deklarata e të pandehurës A. B.e dhen në Stacionin Policor në M. me dt. 16.02.2020, deklarata e dëshmitarit L. M. e dhen në Stacionin Policor në M. me dt. 16.02.2020, si dhe CD-ja, prova këto të mjaftueshme dhe te besueshme për gjykatën, për ta deklaruar fajtor të akuzuarën.

Vendimin mbi udhëzimin në kontest civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par 1 dhe.2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështet në

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimit e konform nenit 365 e 495 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.100/20, me dt. 28.05.2021.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të te njëjtit, kësaj Gjykate, në të kundërtën nëse i akuzuari nuk e ushtron kundërshtimin, aktgjykim do ta marr formën e prerë.

Numri i lëndës: 2020:078602
Datë: 28.05.2021
Numri i dokumentit: 01827774